



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 888 prot.

Tiranë, më 21.03 2025

URDHËR

Nr 40 datë 21 .03 2025

“PËR

NGRITJEN E NJËSISË PËRGJEGJËSE PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN
E SINJALIZUESVE NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të nenit 147/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, të pikës 5 dhe të pikës 11, të vendimit nr. 816, datë 16.11.2016 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”,

URDHËROJ:

1. Përbërjen e njësisë përgjegjëse të përhershme për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të jetë me një punonjës, si më poshtë vijon:
 - Znj. Zonje Shelqizi Specialist (Burime Njerëzore), në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.
 - Znj. Ornela Shurdhaj Ndihmës Inspektor, Njësia e Ndihmës Inspektorëve.
2. Njësia Përgjegjëse ndjek në vazhdimësi sinjalizimin e një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni si dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga hakmarrja në veprimtarinë e saj, duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me ILDKPKI-në.

3. Ngarkohet njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve për zbatimin e këtij Urdhri dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, për njoftimin e këtij Urdhri.

4. Urdhri nr. 119, datë 31.12.2024, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shfuqizohet.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani